

# NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

## 1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia Selenicë  
Adresa Rruga 'Llambi Bomban', Selenicë  
Tel/Faks \_\_\_\_\_  
E-mail [info.prokurimet@bashkiaselenice.gov.al](mailto:info.prokurimet@bashkiaselenice.gov.al)  
Ueb-faqe [selenica.gov.al](http://selenica.gov.al)

## 2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Tea Haxhijaj  
E-mail [teahaxhijaj@yahoo.com](mailto:teahaxhijaj@yahoo.com)

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** e hapur e thjeshtur

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër:** mallra

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:** REF – 28537 – 11 – 07 – 2024

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** Blerje Automjete

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Automjete

**8. Fondi limit:** 8,300,000 (tete milion e treqind mije) Leke pa TVSH

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:**

Per saktësim dhe shtese ne kriteret e vecanta.

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:**

### **Shënim:**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.**

## Shtohet

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesemarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B, sipas Udhëzimit Nr. 1546 datë 29.03.2016, “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomike të huaj.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 5/a, i cili përcakton se:

[Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose.....]

Kjo licensë është kërkuar duke marrë shkas nga llojet e mallrave që do të ofrohen/ blihen nga AK dhe konform VKM Nr 538 dt 26.05.2009 për “Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullimi të tjera nënligjore të përbashkëta” (e ndryshuar). Kjo lloj license si më poshtë vijon ndër të cilat përfshihet edhe kërkesa objekt prokurimi:

"Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocisë së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;

dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

....Vërteton ekzistencën dhe përshtatshmërinë e OE lidhur me tregtimin/ shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkiove.

Kërkesa e DST, pika 2.3.6 “Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, është në përputhje dhe në proporcion me nevojat dhe aktivitetet e kontratës si dhe me qëllimin final të kësaj kontrate, pasi licenca VII.3.B.1, **Pika d. i referohet pikërisht** “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio;”.

**Kërkesa e mësipërme bazohet në:** Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006, “për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” -VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar. - Udhëzim Nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi I mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”

**TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR**